



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 30.07.2019)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Caktimi në pozicion i gjyqtarëve të emëruar më datë 19.07.2019”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 13:04.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                            |                          |
|----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>  | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>      | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ilir Toska</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Brunilda Kadi.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
7. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
8. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
10. *Edlira Bako, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
11. *Marjana Papa, OSCE.*
12. *Klodian Rado, EURALIUS.*
13. *Erjon Fejzulla, USAID.*
14. *Përfaqësues të medias (Prezent vetëm në pikën e parë.)*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Caktimi në pozicion i gjyqtarëve të emëruar më datë 19.07.2019”.

*Naureda Llagami:* Përshëndetje!

Atëherë, siç e kemi parashikuar në njoftim, sot Këshilli do mbajë mbledhjen e radhës të parashikuar në datën 30 korrik 2019. Të pranishëm janë të gjithë anëtarët e Këshillit, përveç zonjës Kadi, me arsye të justifikuara, e cila nuk është prezent këtu.

Siç jeni në dijeni lidhur me rendin e ditës, sot kemi 5 çështje për diskutim, që kërkojnë vendimmarrjen e Këshillit, duke filluar së pari, është çështja për shqyrtimin e projektvendimit lidhur me caktimin në pozicionin e gjyqtarëve të emëruar më datë 19.07.2019. Bëhet fjalë për magistratët. Së dyti, është shqyrtimi i projektvendimit për

miratimin e projektbuxhetit afatmesëm 2020-2022 për pushtetin gjyqësor (faza e dytë), i përgatitur edhe ky nga Komisioni i Planifikimit Strategjik të Administratës dhe Buxhetit. Çështja e tretë e rendit të ditës lidhet me shqyrtimin e projektvendimit për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, zotit Shikim Korbi, për shkak të dorëheqjes. Çështja e katërt ka të bëjë me raportin informues mbi shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-KLD-së për arkivimin/mbylljen e hetimit ndaj një gjyqtari. Dhe çështja e fundit ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor për datat respektive 17 qershor 2019, 21 qershor, 5 korrik, 9 korrik dhe 15 korrik.

Atëherë, nëse nuk keni ndonjë gjë lidhur me rendin e ditës, kalojmë me çështjen e parë, e cila ka të bëjë me caktimin në pozicion të gjyqtarëve të emëruar nga Këshilli më datë 19.07.2019 Doja t'ju thosha që miratimi i këtij projektvendimi për caktimin në pozicion të 10 magistratëve të rinj të diplomuar në Shkollën e Magistraturës në vitin 2018 është një ngjarje shumë e rëndësishme për Këshillin por edhe për vetë sistemin gjyqësor, duke parë këtë fakt mbi situatën e krijuar në organikat e disa gjykatave të vendit për shkak të shkarkimeve të gjyqtarëve nga procesi i vettingut, dorëheqjeve apo edhe daljeve në pension të tyre. Me këtë vendimmarrje, Këshilli sot bën të mundur rifunksionalizimin e disa gjykatave të vogla të cilat kanë probleme me organikat e tyre dhe për pasojë evadimin e çështjeve si dhe shërbimit ndaj publikut.

Sikurse jemi në dijeni, ligji “Për statusin e magistratit në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar që caktimi në pozicionin e të emëruarit të sapo diplomuarit në Shkollën e Magistraturës bazohet në dy kritere: së pari, ka të bëjë me renditjen e tij në listën e të diplomuarve dhe së dyti, në preferencat e shprehura në lidhje me tre gjykata.

Këshilli, në mbledhjen e datës 19 korrik 2019 emëroi si gjyqtarë 10 magistratë të cilët kaluan me sukses procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtarë. Menjëherë, pas emërimit të tyre, Këshilli shpalli 11 vende të lira për këto gjyqtarë, në gjykata të ndryshme të vendit, me qëllim që secili prej tyre të ketë mundësi për të dhënë preferencat e tij.

Për të na dhënë më shumë informacion në lidhje me mënyrën e caktimit të këtyre gjyqtarëve në pozicione të lira, fjalën ia kaloj kryetarit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, zotit Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë, në vijim të asaj që tha Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, sot Këshilli do duhet të finalizojë të gjithë procedurën për caktimin në pozicion të të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018, ku për periudhën gati 6-mujore, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë e ka patur të pamundur, për shkak të ligjit, emërimin e tyre, ndërkohë që Këshilli i Lartë Gjyqësor, menjëherë pas konstituimit të tij arriti të hartojë dhe të miratojë aktet nënligjore që do të mundësonin finalizimin e procesit të caktimit në detyrë të të diplomuarve në vitin 2018, ka bërë procedurat e verifikimit për kualifikimin e tyre për emërim, ka bërë emërimin e tyre dhe tashmë do duhet të bëjë caktimin e tyre në pozicionet përkatëse, ndërsa më herët kemi shpallur 10 gjykata ku mund të caktohen magistratët e diplomuar në vitin 2018, ndërsa kemi kërkuar paraprakisht edhe preferencat e tyre, sikundër ligji përcakton si kriter për caktimin e tyre në pozicion.

Kështu, Këshilli, me vendimin nr. 141, datë 23.07.2019 ka shpallur 11 vende vakante për të aplikuar gjyqtarët e emëruar në mbledhjen e datës 19 korrik 2019. Gjyqtarët e emëruar kanë aplikuar duke zgjedhur 3 preferencat e tyre, ku në varësi të të cilave është bërë edhe një tabelë që të gjithë anëtarët të kenë në konsideratë preferencat e shfaqura nga të emëruarit në datën 19 korrik 2019 dhe më tej Këshilli, për secilin nga të emëruarit në datën 19 korrik 2019, ka përgatitur edhe një projektvendim për caktimin e tyre në pozicionet respektive. Referuar propozimit të bërë nga Komisioni, ndërsa shpallja është bërë për 11 vende vakant, është konsideruar që njëri vend vakant të mos plotësohet me 10 të emëruarit e datës 19 korrik 2019, konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, duke patur në konsideratë për këtë funksionalitetin e 11 gjykatave të shpallura më herët nga Këshilli, ku më emergjente janë 10 gjykatat e tjera, në raport me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, e cila aktualisht ka 6 gjyqtarë në detyrë, 1 gjyqtare që pritet të kthehet në detyrë pas përfundimit të lejes së lindjes në shtator të vitit 2019, ndërsa 1 gjyqtar tjetër i kësaj gjykate është i transferuar përkohësisht në një gjykatë tjetër, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Më tej, sa i përket caktimit në pozicion të të emëruarve, Komisioni konsideroi kriterin ligjor, pra atë të renditjes në bazë të rezultateve të shkollës dhe preferencat e shfaqura nga të emëruarit, ku për 7 nga ata, propozimi konsiston në preferencën e parë të

tyre, në një rast propozimi konsiston në preferencën e dytë dhe në një rast propozimi konsiston në preferencën e tretë. Vetëm në një rast propozimi i Komisionit nuk konsideron preferencat e të emëruarit, kjo për shkak si i emëruari në këtë rast renditet i tretë sa i përket rezultateve në Shkollën e Magjistraturës, ndërsa për pozicionin ku është propozuar, përveç tij, plotëson kriteret vetëm i emëruari i renditur i pari, i cili nuk ka përzgjedhur në preferencat e tij këtë pozicion, pra pozicionin në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Caktimi në këtë pozicion është tepër emergjent, ndërsa në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është aktualisht në detyrë vetëm një gjyqtar edhe ky i transferuar përkohësisht, transferim ky që përfundon me datë 15.09.2019.

Lidhur me kriteret e caktimit në këtë pozicion, Komisioni ka në konsideratë përcaktimin e bërë në pikën 5 të nenit 39 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit i emëruari që caktohet në pozicion në gjykatat administrative, duhet të ketë përvojë pune në të paktën një vit e gjysmë në administratën publike ose të ketë rezultate “shumë të mira” në lëndët e së drejtës administrative në Shkollën e Magjistraturës. Vlen të theksohet se, sipas shkronjës /a/, pika 1, të nenit 41 të ligjit të sipërpërmendur, ku rregullohen të drejtat dhe detyrimet e të emëruarit, i emëruari duhet të pranojë pozicionin e ofruar në përputhje me nenet 39 dhe 40, të këtij ligji, duke përfshirë pozicionin që nuk është deklaruar në preferencat e tij.

Në secilin nga projektvendimet përkatëse për secilin nga gjyqtarët e emëruar në datën 19 korrik 2019 është përcaktuar përveç pozicionit ku duhet të caktohet gjyqtari i emëruar dhe specifikimet sa i përket marrëdhënieve financiare që duhet të fillojnë ditën e emërimit të gjyqtarëve, që është data 19 korrik 2019.

Ka një rregullim sa i përket momentit të hyrjes në fuqi të vendimit të caktimit në pozicion, që është pikërisht ditën e njoftimit në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga gjyqtari i emëruar, si dhe është përcaktuar edhe fakti se kundër vendimit mund të bëhet edhe ankim, sipas ligjit, në Gjykatën Administrative të Apelit, afat i ankimit ky që fillon nga dita e njoftimit të vendimit.

Është përcaktuar gjithashtu edhe detyrimi i Këshillit për të botuar këtë vendim në faqen zyrtare të internetit të tij. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, jemi dakord me propozimet e bëra nga Komisioni lidhur me caktimin e magjistratëve të emëruar ose kemi ndonjë koment?

**Ilir Toska:** Atëherë, mund të specifikoj, për gjyqtaren e emëruar {...}, propozimi konsiston në caktimin e saj në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje. Për gjyqtarin e emëruar {...}, propozimi konsiston në caktimin në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Për gjyqtaren {...} propozimi konsiston në caktimin në pozicion pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Për gjyqtarin e emëruar

{...}, propozimi konsiston në caktimin në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Për gjyqtaren e emëruar {...}, propozimi konsiston në caktimin në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Për gjyqtaren e emëruar {...}{...}j, propozimi konsiston në caktimin në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Për gjyqtaren e emëruar {...}, propozimi konsiston në caktimin në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Për gjyqtaren e emëruar znj. {...}, propozimi konsiston në caktimin në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë. Për gjyqtarin e emëruar zotin {...}, propozimi konsiston në caktimin në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Për gjyqtaren e emëruar {...}, propozimi konsiston në caktimin në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë sugjerim, koment?

Nëse jo, kalojmë me miratimin e propozimeve të bëra sipas Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Atëherë, propozimi i parë i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës ishte që për gjyqtaren e emëruar, zonja {...}, të caktohet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje. Jemi dakord me këtë propozim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi që: Gjyqtarja e emëruar znj. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Marrëdhëniet financiare fillojnë në ditën e emërimit si gjyqtar, datë 19.07.2019. Ky vendim hyn në fuqi në datën e njoftimit të së emëruarës, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga ajo. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën Administrative të Apelit. Afati i ankimit fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë me propozimin e dytë. Propozimi i dytë lidhet me të emëruarin, zoti {...}, sikurse relatoi zoti Toska, propozimi i Komisionit është që zoti {...} të caktohet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Jemi dakord me këtë propozim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi që: Gjyqtari i emëruar z. {...} caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Marrëdhëniet financiare fillojnë nga dita e emërimit gjyqtar, datë 19.07.2019. Ky vendim hyn në fuqi në datën e njoftimit të të emëruarit, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga ai. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën Administrative të Apelit. Afati i ankimit fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë me propozimin tjetër. Lidhur me të emëruarën, zonjën {...}, Komisioni propozon të caktohet në pozicionin pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Kalojmë në votim lidhur me këtë propozim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi që: Gjyqtarja e emëruar znj. {...} të caktohet në pozicionin pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Marrëdhëniet financiare fillojnë nga dita e emërimit gjyqtar, datë 19.07.2019. Ky vendim hyn në fuqi në datën e njoftimit të të emëruarës, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga ajo. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën Administrative të Apelit. Afati i ankimit fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në propozimin tjetër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Lidhur me të emëruarin, zotin {...}, për të cilin Komisioni propozon të caktohet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Jemi dakord me propozimin e bërë?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.



**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi që: Gjyqtari i emëruar z. {...} caktohet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Marrëdhëniet financiare fillojnë nga dita e emërimit gjyqtar, datë 19.07.2019. Ky vendim hyn në fuqi në datën e njoftimit të të emëruarit, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga ai. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën Administrative të Apelit. Afati i ankimit fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në propozimin tjetër të Komisionit, për zonjën {...}, të emëruarën {...}, Komisioni propozon të caktohet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Jemi dakord me propozimin e bërë?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi që: Gjyqtarja e emëruar znj. {...} të caktohet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Marrëdhëniet financiare fillojnë nga dita e emërimit gjyqtar, datë 19.07.2019. Ky vendim hyn në fuqi në datën e njoftimit të të emëruarës, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga ajo. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën Administrative të Apelit. Afati i ankimit fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë me propozimin tjetër, për të emëruar zonjën {...}, për të cilën Komisioni ka propozuar të caktohet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ilir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Pro.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi që: Gjyqtarja e emëruar znj. {...} të caktohet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Marrëdhëniet financiare fillojnë nga dita e emërimit gjyqtar, datë 19.07.2019. Ky vendim hyn në fuqi në datën e njoftimit të të emëruarës, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga ajo. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën Administrative të Apelit. Afati i ankimit fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në propozimin tjetër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës që bëhet fjalë për të emëruarën {...}. Sipas këtij Komisioni, propozohet të caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Jemi dakord me propozimin e bërë nga Komisioni?

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ilir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Pro.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi që: Gjyqtarja e emëruar znj. {...} të caktohet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Marrëdhëniet financiare fillojnë në ditën e emërimit gjyqtar, datë 19.07.2019. Ky vendim hyn në fuqi në datën e njoftimit të të emëruarës, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga ajo. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën Administrative të Apelit. Afati i ankimit fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë me propozimin tjetër të radhës, që bëhet fjalë për të emëruarën

{...}, për të cilën Komisioni ka propozuar të caktohet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë. Jemi dakord me propozimin e Komisionit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi që: Gjyqtarja e emëruar znj. {...} të caktohet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë. Marrëdhëniet financiare fillojnë nga dita e emërimit gjyqtar, datë 19.07.2019. Ky vendim hyn në fuqi në datën e njoftimit të të emëruarës, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga ajo. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën Administrative të Apelit. Afati i ankimit fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në propozimin tjetër të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për të emëruarin, zotin {...}, i cili caktohet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Gjyqtari i emëruar z. {...}caktohet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Marrëdhëniet financiare fillojnë nga dita e emërimit gjyqtar, datë 19.07.2019. Ky vendim hyn në fuqi në datën e njoftimit të të emëruarit, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga ai. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën Administrative të Apelit. Afati i ankimit fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në propozimin e radhës të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, që bëhet për zonjën {...}. Sipas propozimit të Komisionit, e emëruara caktohet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Jemi dakord me propozimin e bërë nga Komisioni?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Gjyqtarja e emëruar {...} caktohet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Marrëdhëniet financiare fillojnë nga dita e emërimit gjyqtar, datë 19.07.2019. Ky vendim hyn në fuqi në datën e njoftimit të të emëruarës, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga ajo. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën Administrative të Apelit. Afati i ankimit fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me këtë vendimmarrje përfunduar lidhur me çështjen e parë që kishim, të rendit të ditës.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbajtur, më 30.07.2019)*

***Pika 2 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e projektbuxhetit afatmesëm 2020-2022 për pushtetin gjyqësor (faza e dytë)” i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 13:04.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Ilir Toska*** (anëtar)
- 7. Alban Toro*** (anëtar)
- 8. Brikena Ukperaj*** (anëtar)
- 9. Erjon Muharremaj*** (anëtar)
- 10. Marçela Shehu*** (anëtare)

*Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Brunilda Kadi.*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
- 10. Edlira Bako, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Marjana Papa, OSCE.*
- 12. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 13. Erjon Fejzulla, USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e projektbuxhetit afatmesëm 2020-2022 për pushtetin gjyqësor (faza e dytë)” i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës.

*(Ndërkohë kameramanët largohen nga salla e mbledhjes.)*

Atëherë, vazhdojmë me çështjen e radhës së rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e projektbuxhetit afatmesëm 2020-2022 për pushtetin gjyqësor (faza e dytë)” i përgatitur ky nga Komisioni i Planifikimit Strategjik.

Tani, lidhur me buxhetin e sistemit gjyqësor të Republikës së Shqipërisë, ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikon ndër të tjera dy funksione të rëndësishme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kështu parashikohet që KLGJ-ja, si organ përgjegjës, është përgjegjës për miratimin e buxhetit vjetor dhe afatmesëm të tij, në konsultim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave. Gjithashtu, ky institucion duhet të kryejë edhe mbikëqyrjen e shpenzimeve, shpërndarjen e fondeve dhe mbajtjen e llogarive të sakta sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Nisur nga sa më sipër dhe mbështetur në legjislacionin financiar aktual, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit të KLGJ-së ka hartuar projektbuxhetin afatmesëm 2020-2022. Ky i fundit përmban shpenzime dhe kërkesat buxhetore për tre vitet e ardhshme si në lidhje me institucionin e KLGJ-së ashtu edhe për të gjithë gjykatat e vendit. Ky projektbuxhet pason dokumentet e fazës paraprake të PBA-së 2020-2022 të hartuara dhe të miratuara nga Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS-ja) dhe vlen të theksohet që ky dokument që propozojmë sot për miratim është konsultuar dhe dakordësuar me Ministrinë e Drejtësisë. Në hartimin e këtij projektbuxheti është marrë në konsideratë dhe plani strategjik i Këshillit të Lartë Gjyqësor për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë viti 2019-2020, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, e cila synon të ndërtojë një vend që bazohet në sundim të ligjit dhe që garanton respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përmes një sistemi të hapur dhe të barabartë drejtësie.

Në vijim, më lejoni që të ftoj zonjën {...}, për të na bërë një pasqyrim më të detajuar lidhur me zërat e këtij plani buxhetor që neve po kalojmë sot. Faleminderit!

{...}: Faleminderit!

Në hartimin e projektbuxhetit afatmesëm 2020-2022, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit është mbështetur në ligjin “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” dhe në Udhëzimin nr. 8 “Për përgatitjen e projektbuxhetit afatmesëm 2020 – 2022”.



Në zbatim të Udhëzimit nr.7, për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, me urdhrin nr. 134, datë 09.04. është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i kryesuar nga Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjithashtu me pjesëmarrje zonjën Naureda Llagami si dhe me anëtarë zotin Maksim Qoku (Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor), zotin {...} (Sekretar i Përgjithshëm) dhe zonjën {...} (Drejtoresh e Buxhetit).

Në mbledhjen e datës 17 prill 2019, GMS shqyrtoi dhe miratoi, dokumentat e Fazës së I strategjike të PBA.

Deri më datën 30 prill 2019 u përfundua projektbuxheti i integruar i pushtetit gjyqësor, që përmban kërkesat buxhetore të programit buxhetor “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, për institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe si kërkesat për programin buxhetor “Buxheti Gjyqësor”, për funksionimin e aktivitetit të gjykatave në të tre nivelet.

Në neni 95, pika 3 e ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është përcaktuar se “Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për hartimin e buxhetit vjetor dhe afatmesëm të tij në konsultim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave”.

Në zbatim të sa më sipër, i është kërkuar Ministrisë së Drejtësisë konsultimi i Projekt Buxhetit Afatmesëm të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Ky konsultim me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë u krye në datën 11.07.2019 ku drejtuan pyetje që kishin të bënin kryesisht me përfshirjen në PBA të masave të përcaktuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017-2020. Në takim u konstatua se këto masa janë të përfshira në PBA-në 2020-2022.

Ndërsa konsultimi me Ministrinë e Financave, kryhet nëpërmjet takimeve negociuese për Fazën e I dhe Fazën e II të PBA-së.

Konsultimi i Fazës I është kryer në datë 29.05.2019, ku u parashtruan kërkesat buxhetore 2020-2022, në mënyrë të detajuar dhe me argumentat përkatëse.

Konkretisht, kërkesat për buxhetin afatmesëm për të gjithë pushtetin gjyqësor janë: për shpenzime korente 3.4 miliard lekë, për shpenzime kapitale 271.5 milion lekë dhe në total 3.7 miliard lekë për vitin 2020. Gjithashtu janë përfshirë edhe kërkesat për

vitin 2021 dhe 2022 të cilat janë: 3.6 miliard lekë për vitin 2021 dhe 3.6 miliard lekë për vitin 2022.

Për citin 2020 mund t'ju paraqesim disa të dhëna edhe më të hollësishme ku përfshihen shpenzimet korente, ku janë pagat edhe sigurimet) si dhe shpenzimet kapitale (ku përfshihen të gjitha nevojat për investime në tre komponentët që kryesisht kanë të bëjnë me infrastrukturën elektronike, pajisje të ndryshme si dhe nevojat që kanë paraqitur gjykatat për automjete.

Pjesa që i takon kërkesave buxhetore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për vitin 2020, në total janë 347.3 milion lekë. Në këto kërkesa është paraqitur kërkesa për shpenzimin e pagave për strukturën e plotë tashmë (për vitin 2020) si dhe nevojat për shpenzime operative. Kjo është realizuar nëpërmjet një detajimi të qartë dhe të plotë të përcaktuar për të gjithë nevojat që parashikohet të ketë Këshilli i Lartë Gjyqësor për vitin 2020. Gjithashtu janë parashikuar edhe nevojat për shpenzime kapitale.

Gjatë negociatës që u realizua në fazën e I me Ministrinë e Financave, rezultoi që ka një diferencë shumë të madhe me tavanet, por u dakordësua dhe u kuptua qartë që në tavanet e vendosura për Këshillin e Lartë Gjyqësor, nuk ishin marrë në konsideratë struktura e re që është ngritur por i janë referuar tavaneve të mëparshme (ish-KLD-ja).

Ndërsa, për sa i përket kërkesave buxhetore për gjykatat, sigurisht që ky është një proces i komplikuar dhe mbledh në mënyrë të qartë dhe të plotë kërkesat nga të gjitha gjykatat e vendit. Ajo që mund të theksojmë këtu është që ka një diferencë, kërkesat buxhetore për vitin 2020 është 3.1 miliard lekë që i përket nevojave për gjykatat (3.1 miliard lekë janë tavanet), ndërsa kërkesa është 3.3 miliard lekë. Diferenca vjen për shkak se e gjithë kërkesa është fokusuar kryesisht në një shtesë që është kërkuar për numrin e punonjësve prej 27 punonjës për administratën gjyqësore. Sigurisht, kjo është një kërkesë e argumentuar dhe bazohet në kërkesat e ligjit “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor”, në kërkesat dhe nevojën që kanë paraqitur vazhdimisht gjykatat si dhe në standardet evropiane për mbështetjen e gjyqtarëve me staf administrativ dhe sigurimin e efijencës së shërbimit gjyqësor. Ky do të jetë edhe fokusi kryesor i kërkesës që do të kemi në negociatën e dytë me Ministrinë e Financave. Meqenëse, për të qenë eficient edhe në përdorimin e buxheteve edhe në kërkesat tona, kërkesat për shpenzime kapitale janë kërkuar brenda tavanit. Kjo vjen për arsye se nuk është miratuar akoma harta gjyqësore

dhe pas miratimit të saj do të kemi edhe më të qartë situatën për të ndërtuar një plan strategjik për godinat në mënyrë që ajo të vijë në përputhje me miratimin e hartës së re.

Ndërsa, gjithashtu një kërkesë shtesë mbi tavan kemi në shpenzime operative për sa i përket gjykatave dhe këtu argumentet janë të qartë, bëhet fjalë për kontratën e re të shërbimit për mirëmbajtjen e Sistemit ICMIS e cila më parë ka qenë e administruar nga Ministria e Drejtësisë. Gjithashtu bëhet fjalë për rritjen e pagës minimale që ka të bëjë me rritjen e shpenzimeve për ruajtjen e gjykatave, si dhe është përlllogaritur edhe shtesa që i takon sipas teknikave të përcaktuara në udhëzimin përkatës për përgatitjen e buxhetit, që ka të bëjë me rritjen me 2% të vlerës së investimit për rritjen e sipërfaqes së godinave të 1 viti të mëparshëm. Këto janë faktorët kryesor që kanë ndikuar në këtë shtesë që kemi kërkuar për shpenzime operative.

Materiali i plotë i është kaluar Komisionit të Strategjisë dhe Buxhetit dhe gjithashtu e rëndësishme do të jetë edhe takimi i dytë negociues me Ministrinë e Financave që do të zhvillohet më 25 shtator. Ky takim kryesohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe sikurse kemi diskutuar edhe në Komisionin e Strategjisë dhe Buxhetit edhe për rrethanat që jemi, fokusi do të jetë pikërisht në kërkesën për sigurimin e shtesës së numrit të punonjësve për administratën gjyqësore. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja {...}!

Nëse keni ndonjë pyetje ose ndonjë koment lidhur me këtë fazë të hartimit dhe planifikimit të buxhetit?

Atëherë, kalojmë në votim projekt propozimin e bërë nga Komisioni i Strategjisë dhe i Buxhetit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Miratimin e projektbuxhetit afatmesëm 2020 – 2022 të pushtetit gjyqësor (faza e dytë) sipas tekstit dhe pasqyrave bashkëlidhur të propozuar nga Komisioni. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 30.07.2019)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës z. {...}, për shkak të dorëheqjes”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 13:04.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

*Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Brunilda Kadi.*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
- 10. Edlira Bako, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Marjana Papa, OSCE.*
- 12. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 13. Erjon Fejzulla, USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës z. {...}, për shkak të dorëheqjes”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin dhe vendimmarrjen për një akt individual, që bëhet fjalë për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës z. {...}, për shkak të dorëheqjes”. Ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni i

Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit dhe do relatohet nga zonja Fatmira Luli.

***Fatmira Luli:*** Faleminderit, Kryetare!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është depozituar dhe protokolluar kërkesa e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Kukës, i cili informon për situatën e krijuar në gjykatë për shkak të kërkesës për dorëheqje të kancelarit të gjykatës.

Gjithashtu është depozituar edhe kërkesa e kancelarit z. {...}, me nr. protokollit 256, datë 27.06.2019, me anë të së cilës ai ka paraqitur aktin e dorëheqjes së tij për miratim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. {...} është emëruar në këtë gjykatë me urdhrin 73/2001, nga Ministri i Drejtësisë dhe ka ushtruar këtë detyrë për rreth 20 vjet. Ai ka shprehur vullnetin e tij për të kërkuar dorëheqjen si rrjedhojë e emërimit të tij në pozicionin avokat shteti pranë institucionit të Avokaturës së Shtetit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90, pika /c/ të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka në kompetencë ndër të tjera emërimin e kancelarëve të gjykatave. Në nenin 59, pika 1, të ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” caktohet se: Organi kompetent për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit është Këshilli i Lartë Gjyqësor”. Po kështu, lidhur me vijimin e marrëdhënieve të punës dhe ndërprerjen e tij, në nenin 80 të ligjit 96/2016, ku theksohet se: “3.Organi kompetent për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe për nëpunësit e tjerë civilë është Këshilli i Gjykatës ku ai ushtron detyrën.”

Gjithashtu në këtë dispozitë theksohet se ndërprerja e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor i nënshtrohet rregullave të parashikuara në ligjin “Për nëpunësin civil”, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Pra, më sipër organi kompetent për emërimin e kancelarëve pranë gjykatave është Këshilli i Lartë Gjyqësor, dhe po kështu edhe në rastin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, është po ky organ.

Në nenin 64, të ligjit 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil” parashikohet se nëpunësi mund të njoftojë përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim te njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku ushtron detyrën, ose DAP-it, në rastin e nëpunësit të lartë drejtues. Ndërkohë që ky ligj

parashikon që dorëheqja prodhon efektet 30 ditë nga data e paraqitjes së saj, ashtu si dhe në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuara mund të mos respektohet afatit 30-ditor nga njoftimi i parashikuar në ligj.

Sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit, në kushtet e paraqitjes së dorëheqjes së motivuar të Kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës për shkak të fitimit të konkursit për të qenë pjesë e Avokaturës së Shtetit, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: 1. Ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës z. {...}, për shkak të dorëheqjes. 2. Njoftimin e këtij vendimi z. {...}si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Luli!

Po, zoti Bici!

**Medi Bici:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Për të saktësuar nja dy gjëra.

Mendoj që baza ligjore për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës tek kancelari {...}, nuk është e saktë, pasi neni 80 i ligjit 96/2016 për Statusin, bën fjalë për aftësitë drejtuese dhe organizative të kryetarit të gjykatës. Baza ligjore e saktë është neni 80, paragrafi 3, i ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”. Aty parashikohet ajo çka tha edhe zonja Fatmira.

Një problem tjetër që shoh në vendim është se duhet të saktësohet data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Ashtu është, që ligji nr. 152/2013 “Për statusin e nëpunësit” thotë 30 ditë pas, por mendoj që në vendim duhet të saktësohet data e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ashtu siç u saktësua për gjyqtarët data e fillimit.

**Naureda Llagami:** Për saktësi, kemi 90, pika /c/ e ligjit “Për organet e qeverisjes” që është vendimmarrja e Këshillit dhe kemi 80, të ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, i cili është ligji ku shprehet që Këshillat, lidhur me kancelarët dhe ndihmësit...

*(Zoti Bici ndërhyr pa ndezur mikrofonin.)*

E ka relacioni. Ka lapsus.

**Fatmira Luli:** Është cituar dispozita konkrete.



**Naureda Llagami:** Ai është lapsus në relacion, ndërkohë që në vendim është e saktë. Do ta reflektojmë në zbardhjen e relacionit, -pa merak!

Lidhur me përcaktimin e një afati, mendoni që duhet ta përcaktojmë? Nuk hyn afati automatikisht me marrjen/me shpalljen e vendimit? Ka nevojë ta themi? Momenti që i komunikohet, konsiderohet edhe zgjidhja e marrëdhënies së punës, ndërprerja e marrëdhënies së punës.

**Ilir Toska:** Sa i përket hyrjes në fuqi është ai që duhet t'i komunikohet nëpunësit civil gjyqësor. Sa i përket vendimmarrjes se kur duhet të ndërpritet, ose duhet të konsiderojmë që ndërprerja është në momentin që ky vendim hyn në fuqi menjëherë ose do duhet të saktësojmë datën, siç propozoi zoti Bici, ta themi datën tek paragrafi i parë.

**Brikena Ukperaj:** Mund të shtoj diçka?

Atëherë, për të vazhduar logjikën e zotit Toska, duke qenë se kancelari ka depozituar aktin e dorëheqjes në datën 01.07.2019, efektet financiare do t'i fillojnë pas 30 ditësh, kështu që ne mund të vendosim në vendim që “efektet financiare të tij përfundojnë në datën 31.07.2019”, -vetëm kjo duhet të shtohet. Për efektet financiare, të përcaktohet.

...ose mund të shtojmë tek pika 1 “1. Ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës z. {...}, për shkak të dorëheqjes me efekte financiare nga data ose deri në datën 31.07.2019.”

**Naureda Llagami:** Atëherë, jemi dakord me propozimin e bërë nga zonja Ukperaj lidhur me shtimin e një pike në projektvendim ku konkretisht të thuhet që “marrëdhëniet financiare përfundojnë më datë 31 korrik 2019”.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës z. {...}, për shkak të dorëheqjes. Pika e dytë është: Marrëdhëniet financiare përfundojnë më datë 31.07.2019. Pika e tretë e këtij projektvendimi është: Njoftimin e këtij vendimi z. {...}si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 30.07.2019)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Raport “Mbi shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-KLD-së për arkivimin/mbylljen e hetimit ndaj një gjyqtari”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 13:04.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

*Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Brunilda Kadi.*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
- 10. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Marjana Papa, OSCE.*
- 12. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 13. Erjon Fejzulla, USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Raport “Mbi shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-KLD-së për arkivimin/mbylljen e hetimit ndaj një gjyqtari”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës e cila ka të bëjë lidhur me Raportimin “Mbi shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-KLD-së për arkivimin/mbylljen e hetimit ndaj një gjyqtari”.

Siç jeni në dijeni Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin e tij të datës 14.02.2019 ngriti një Komision të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose

pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari. Pas një pune disamujore, anëtarët e Komisionit të Përkohshëm, kanë përgatitur një raport njohës për Këshillin. Për më shumë, fjalën po ia kaloj kryetares së Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, zonjës Fatmira Luli.

***Fatmira Luli:*** Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 62, pika 13 dhe 14 e ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në nenet 121, 122 dhe 134 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me vendimin nr. 31, datë 14.02.2019 ka vendosur ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.

Pas miratimit të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari” me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 52, datë 27.03.2019, Komisioni bazuar në nenin 4 të Rregullores “Organizimi dhe funksionimi i Komisionit”, pika 3 e tij, ka bërë ndarjen e ankesave me short, bazuar në rregullore, midis anëtarëve të Komisionit në mbledhjen e datës 02.04.2019, ku konkretisht:

z. Alban Toro mori në shqyrtim ankesat e listuara nga nr. 1 deri në nr. 61, të regjistruara sipas datës së protokollimit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë; z. Dritan Hallunaj ankesat e listuara nga nr. 62 deri në nr. 122 dhe këto të regjistruara sipas datës së regjistrimit në KLD; znj. Fatmira Luli ankesat e listuara nga nr. 123 deri në nr. 183 të regjistruara sipas kohës së paraqitjes dhe regjistrimi i tyre në protokollin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Shqyrtimi i këtyre ankimeve është dokumentuar në procesverbalet e mbajtura për këtë qëllim në datat si më poshtë:

Në mbledhjen e Komisionit datë 11.04.2019, Komisioni u njoh me përmbajtjen e praktikave të shpërndara sipas shortit të bërë më datë 02.04.2019 mbi ankesat ndaj vendimeve të arkivimit të Kryeinspektorit të ish-KLD, përfshirë këtu ankesën fillestare të subjektit, relacionin e inspektorit të ish-IKLD, vendimin e arkivimit, ankesën ndaj

vendimit të arkivimit, si dhe formatin i vendimit tip, format i cili do të plotësohej rast pas rasti. Në këtë mbledhje u plotësua formati tip për të tëra vendimet që do të merrnin të tre anëtarët e këtij Komisioni të Përkohshëm.

Në mbledhjet e Komisionit të datave 13.05.2019, 21.05.2019, 11.06., 21.06. dhe 16.07. janë shqyrtuar të gjitha ankimet ndaj vendimeve të arkivimit të Kryeinspektorit të ish-KLD-së, ku pas çdo shqyrtimi, të tre anëtarët kanë votuar rast pas rasti, mbi pranimin ose jo të ankimit së subjektit përkatës.

Në lidhje me objektin e këtyre ankesave, Komisioni doli në konkluzionin e mëposhtëm: së pari, ankimet kanë pasur si objekt mënyrën se si gjyqtari ka vlerësuar dhe ka interpretuar ligjin dhe pretendime të tilla gjithmonë në praktikën e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe sipas ligjit zgjidhen vetëm nëpërmjet rrugës së apelimit në gjykata më të larta sepse është kompetencë e shqyrtimit gjyqësor nga gjykata; rasti i dytë i ankimeve përfshinte ankimet që kanë pasur si objekt pretendime mbi fakte e rrethana të ndodhura para 5 viteve dhe pretendime të tilla janë të parashkruara sipas nenit 117 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i cili parashikon se “Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda 5 vjetëve. Afati i parashikimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer”. Kategoria e tretë e ankimeve përfshinte pretendime në lidhje me institucione ekstra gjyqësore (prokurori, administratë) ose individë jomagjistratë dhe pretendime të tilla nuk kanë lidhje me objektin e veprimtarisë së Inspektoratit të KLD. Dhe së fundi, një pjesë e madhe e ankimeve s’qenë të formuluar konform ligjit, referonin gjykatën në përgjithësi apo referonin prokurorinë dhe nuk referonin gjyqtarin konkret dhe shkeljen konkrete për të cilën ato kishin bërë ankim. Binte në sy në tërë shqyrtimin e ankimeve që një pjesë e madhe e ankuesve ishin ankues përsëritës të cilët përsërisnin në mënyrë të vazhdueshme ankimet dhe të tëra këto ankime ishin regjistruar në protokoll si ankime fillestare, pra është marrë vendim individual për secilin ankim, ndonëse ankuesit (disa prej tyre) janë përsëritës.

Në lidhje me pranimin ose mospranimin e 183 ankimeve të shqyrtuara nga Komisioni, u vendos:

Për 181 raste, Komisioni vendosi mospranimin e ankimit për shkak të shkaqeve që parashtrava më sipër sepse ankimet drejtoheshin kundër vendimmarrjes e cila ishte

objekt shqyrtimi gjyqësor ose ishin të parashkruara ose ishin të paformuluara konform nenit 120 dhe nuk kuptohesh shkelja dhe gjyqtari konkret të cilit i referohej.

Për 1 rast, ankuesi ka hequr dorë nga ankimi dhe për këtë shkak Komisioni mori vendim për pushimin e ankimit.

Për 1 rast, Komisioni vendosi pranimin e ankimit, pasi çmoi që shkeljet e konstatuara në veprimtarinë e gjyqtarëve të apelit Vlorë ishin shkelje të rënda të cilat duhet të hetoheshin në momentin e krijimit të ILD, dhe për këtë shkak pranoi ankimin dhe e dërgoi praktikën në pritje pranë ILD-së.

Ky ishte shkurtimisht informacioni që Komisioni parashtron për të tëra vendimet që shqyrtoi.

*Naureda Llagami*: Faleminderit, për relatimin dhe për informimin Këshillit për punën e bërë nga ana e Komisionit.

Nëse keni ndonjë paqartësi ose ndonjë pyetje kundrejt Komisionit jeni të hapur, ndryshe kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila edhe kjo është një vendimmarrje formale.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 30.07.2019)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor për datat 17.06.2019, 21.06.2019, 05.07.2019, 09.07.2019 dhe 15.07.2019.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 13:04.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)



*Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Brunilda Kadi.*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
- 10. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Marjana Papa, OSCE.*
- 12. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 13. Erjon Fejzulla, USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor për datat 17.06.2019, 21.06.2019, 05.07.2019, 09.07.2019 dhe 15.07.2019.

*Naureda Llagami:* Ka të bëjë lidhur me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor për datat 17.06.2019, 21.06.2019, 05.07.2019, 09.07.2019 dhe 15.07.2019. Keni ndonjë gjë lidhur me përmbajtjen?

Shpresojmë që me uebsajtin (*website-in*) e ri nuk do të kemi më nevojë që t'i kemi këto procesverbale kaq të zgjatura sepse do të mundësohet që ne t'i aplodojmë (*uplode-ojmë*) të gjithë mbledhjet tona, kështu që do shpëtojmë edhe nga kjo procedura.

Atëherë, ju ftoj për vendimmarrjen lidhur me miratimin e procesverbaleve.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 17.06.2019, 21.06.2019, 05.07.2019, 09.07.2019 dhe 15.07.2019. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nëse nuk keni ndonjë çështje tjetër për të diskutuar ose për të trajtuar, unë po e mbyll dhe shpresoj pushime të mbara për të gjithë anëtarët dhe duke ju falënderuar edhe për punën intensive që keni bërë gjatë këtyre muajve. Faleminderit!

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**